



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1599/14 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M
Nr. 923/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.873/2026, datë 26.06.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar*”, me Nr. REF: 75953-02-12-2026, me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit”, me fond limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, me NIPT K01529003M, me adresa: Rruga Muhamet Gjollësja 71/3, Kati 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “Climacasa” SHPK me NIPT L07805502F dhe adresë: *Lagjja Beselidhja, Rruga Shtraus , Pallati Nr. 1, kati perdhje, Njesia me numer pronesia 5/82-N1, ZK, Lezhë*

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tirane me adresë: *Rruga “5 Maji”, Godina 17,Tregu i Medresesë, Tiranë*

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, me NIPT K01529003M, me adresa: Rruga Muhamet Gjollësja 71/3, Kati 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “Altec” SHPK, me NIPT K57923807Ë, me adresa: *Ballsh "Mallakaster", Njesia*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021
"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i
ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.
766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave për
organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit
Publik"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.873/2026, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Climacasa" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-75953-02-12-2026, me objekt "Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit" me fond limit 29,981,240.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tirane.*
2. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Sulollari-Klima" SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt - ankimi.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Climacasa" SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Sulollari-Klima" SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1.2. Me shkresën nr. 2847/1 prot., datë 09.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1599/11 prot., datë 13.07.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 873/2026, datë 26.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit *"Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar"*, me Nr. REF: 75953-02-12-2026, me objekt *"Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit"*, me fond limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 2847/1 prot., datë 09.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1599/11 prot., datë 13.07.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 873/2026, datë 26.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-83228-04-24-2026, me objekt “procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar*”, me Nr. REF: 75953-02-12-2026, me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit”, me fond limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

II.2. Nga verifikimi i procedurës në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe informacionit të sipërcituar, të dërguar me shërbim postar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka rivlerësuar ofertën e OE ankimues “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura, në përputhje me vendimin e KPP-së Nr. 873/2026, datë 26.06.2026, sipas së cilit, ka rivlerësuar arsyet e skualifikimit për OE ankimues “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, duke e kualifikuar atë.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar*”, me Nr. REF: 75953-02-12-2026, me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit”, me fond limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu